



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.04.2022)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023, për ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2022–2023 (relator z. Ilir Rusi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Yllka Rupa*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashë.*
2. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
3. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023, për ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2022–2023 (relator z. Ilir Rusi).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 4 prill 2022.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të merren në shqyrtim 3 çështje.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, përveç zonjës Rupa, e cila për shkaqe të arsyeshme e ka të pamundur që të jetë në mbledhjen e sotshme.

Atëherë, tre janë çështjet që do të merren në shqyrtim nga ana e Këshillit.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit

në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023, për ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë ose për ndihmës ligjorë, relator i të cilit do të jetë zoti Ilir Rusi.

Ilir Rusi: Kryetare, faleminderit për fjalën e dhënë!

Përhëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Siç jeni në dijeni, me vendimin nr. 87, datë 09.03.2022 është ngritur Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2022–2023, me përbërje zonjën Irena Plaku, zotin Ridvan Hado dhe zotin Ilir Rusi.

Pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës nga ana e Shkollës së Magjistraturës, ne si Komision kemi kryer verifikimet përkatëse për shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjithë dokumentacionit në tërësi të saj.

Nga konstatimet tona, juve ju është relatuar një relacion (datë 31 mars), në të cilin ne si anëtarë të Komisionit të Përkohshëm kemi pasur edhe reflektimet tona këto ditë dhe relacioni i sotshëm është një relacion përfundimtar për çështjen në lidhje me ndihmësit ligjorë.

Gjithsej ishin 82 (tetëdhjetë e dy) aplikantë dhe nga tërësi e dokumentacionit rezulton që 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) aplikantë kualifikohen, duke plotësuar të gjitha kriteret, ndërsa 6 (gjashtë) aplikantë skualifikohen, duke mos vazhduar më tej garën për ndihmës ligjorë.

Aplikantët të cilët skualifikohen për shkak të mesatares janë: {...}, {...}, {...}, {...} (për shkak se kanë rezultuar me notë mesatare nën kriterin e përcaktuar në notën 7 në grupin e lëndëve kryesore). Ndërsa aplikanti {...} ka rezultuar që të ketë një notë mesatare të përgjithshme në grupin e lëndëve kryesore, nën 7.

Në lidhje me kandidaten {...}, nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit të dorëzuar prej saj dhe të plotësuar në kohë, rezulton që {...} ka një përvojë si juriste, por nuk e ka në kufijtë minimal të përcaktuar nga ligji në lidhje me kohëzgjatjen e saj të marrëdhënies së punës. Në lidhje me këtë çështje ne kemi pasur reflektimin tonë duke

marrë në konsideratë datën në të cilën ne miratuar kuotat për ndihmës ligjorë, data e cila ka qenë dita e fundit e aplikimeve për aplikantët që shprehin interesin për të kandiduar, datën e vendimmarrjes që është data e sotshme e Këshillit apo datën e provimit të formimit e cila zhvillohet nga Shkolla e Magjistraturës.

Në tërësinë tonë, ne si Komision gjykojmë që për të gjithë aplikantët, në trajtim të barabartë të tyre, mendojmë që si datë fundore për t'u vlerësuar kohëzgjatja e marrëdhënies së punës (eksperiencë përkatëse në vite), të jetë data e fundit e aplikimit. Duke marrë këtë datë në konsideratë, rezulton që kandidatja nuk plotëson kriterin e të paktën 3 vjet si eksperiencë aktive me kohë të plotë në profesionin përkatës. Kështu që, për këtë arsye rezulton që të jetë e skualifikuar.

Relacioni ju është dërguar dhe unë mendova për të bërë një përmbledhje sintetike të saj, duke pasur parasysh edhe ekonomizimin e kohës, edhe faktin që të gjitha gjetjet e tjera për 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) kandidatët gjetjet janë në përcaktimet dhe kriteret ligjore për kualifikimin e tyre.

Kështu që, nuk e di nëse zonja Kryetare, të lexoj në mënyrë nominale çdo emër apo të mjaftojmë me faktin që 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) është numri i të kualifikuarve dhe 6 (gjashtë) numri i të skualifikuarve. Po përmend emrat e të skualifikuarve, meqenëse është pjesa më e rëndësishme: {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}.

Naureda Llagami: Dakord.

Emrat e shtatëdhjetë e gjashtëve po i lexoj unë.

Ilir Rusi: Jo, mund t'i lexoj unë Kryetare!

Vazhdoj i lexoj unë më tej.

Të kualifikuarit janë: (lexohen emrat e 76 kandidatëve).

Mbyllet me numrin rendor 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) kandidatë të kualifikuar.

Ndërsa në lidhje me kandidatët e skualifikuar, po i përmend përsëri:

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...};

5. {...};

6. {...}.

Mbyllet me numrin rendor 6 (gjashtë).

Ky ishte një relacion i përmbledhur e nderuar Kryetare, njëkohësisht edhe duke lexuar në mënyrë nominale emrat e të kualifikuarve dhe të skualifikuarve për ndihmës ligjorë.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Rusi!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim për sa i përket listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe atyre që janë skualifikuar.

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Përkohshëm.

Ilir Rusi: Pro projekt-aktit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022 – 2023, për Ndhmës Ligjorë, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi (që u lexua nga zoti Rusi dhe që përfundon me numrin 76 (shtatëdhjetë e gjashtë)).

2. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e

Magjistraturës, për vitin akademik 2022 – 2023, për Ndhmës Ligjorë, sipas Lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi (që përfundon me numrin rendor 6 (gjashtë)).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.04.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga shkolla e magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2022–2023””, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimin në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2022–2023 (relator z. Ilir Rusi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Ilir Rusi (zëvendëskryetar)*
- 3. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Irena Plaku (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ridvan Hado (anëtar)*

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Yllka Rupa*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashë.*
2. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
3. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2022–2023””, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2022–2023 (relator z. Ilir Rusi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e dytë që ka të bëjë me miratimin e komenteve dhe sugjerimeve mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2022–2023. Edhe për këtë projekt–akt, fjalën ia jap zotit Ilir Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Ashtu sikundër kemi vepruar edhe me ndihmësit ligjorë, edhe për magistratët, profili gjyqtar, kemi marrë në dispozicion të gjitha materialet e përcjella nga Shkolla e Magjistraturës dhe sipas këtyre materialeve rezultojnë që, sipas qëndrimit të deritanishëm të Shkollës së Magjistraturës, rezultojnë që 318 (treqind e tetëmbëdhjetë) kandidatë, nga tërësia e tyre, i plotësojnë kriteret për të vazhduar më tej procedurat dhe 37 (tridhjetë e shtatë) aplikues nuk i plotësojnë kriteret (me komentet përkatëse).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i cili është bërë nga ana e Komisionit, rezultojnë që për një pjesë të kandidatëve të kualifikuar, nësi Komisioni i Përkohshëm të kemi qëndrimet tona, përkatësisht (njëkohësisht kemi bërë në kohë edhe reflektimet lidhur me relacionin që kemi hartuar dhe përcjellë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në datë 31 mars 2022); për një grup të aplikantëve, konkretisht për: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë që mesatarja e cila është referuar në aktet e Shkollës së Magjistraturës, rezultojnë që nga përlogaritjet tona rezultojnë një mesatare e ndryshme nga ajo që është përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës. Për këtë fakt, ne sugjerojmë që komisioni apo personat përkatës nga Shkolla e Magjistraturës të bëjnë një rishikim të mesatares, duke pasqyruar qartë metodologjinë e përdorur dhe një trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve, në raport me arsimin e lartë të kryer në fushën drejtësisë, për shkak se edhe në lidhje me legjislacionin “Për arsimin e lartë”, terminologjia e përdorur për diplomat e lëshuara është e ndryshme. Shkolla e Magjistraturës të ketë në konsideratë faktin për t’iu referuar ndryshimeve të fundit ligjore të kryera mbi llojin e studimeve të përfunduara të barasvlershme me to, si dhe përlogaritjen e mesatareve përkatëse. Kështu që sugjerojmë që të rishikojnë edhe një herë ato nivelet e mesatares të përcjella për kandidatët përkatës.

Në lidhje me një aplikantë, që është aplikantja {...}, nga shqyrtimi i relacionit rezultojnë që në librezën e saj të punës të dorëzuar është shënuar “Larguar nga detyra për performacë të ulët”. Me këtë sugjerojmë që të bëhen verifikimet përkatëse për të konstatuar faktin nëse ky shënim është rrjedhojë e një mase disiplinore të marrë ndaj aplikantes në raport me marrëdhënien e punës që ka pasur, apo është rrjedhojë e një nga kriteret apo kushtet e përcaktuara mbi zgjidhjen e marrëdhënies së punës për shkaqe të justifikuara. Për këtë sugjerojmë që Shkolla e Magjistraturës të bëjë verifikimet përkatëse, në komunikim edhe me aplikanten.

Ndërsa, opinionet që kishim mbi dy aplikante, {...} dhe {...}, kemi reflektuar dhe gjykojmë që për to nuk kemi sugjerime/opinione për shkak se edhe përlogaritja e viteve të punës është bërë duke marrë për bazë eksperiencën e tyre sipas profilit “asistente avokate”, në raport edhe me përcaktimet ligjore dhe me frymën e përgjithshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbajtur në vite për këtë kategori aplikantësh.

Ndërsa po t’i referohemi grupit të aplikantëve të cilët Shkolla e Magjistraturës deri më tani ka një qëndrim për t’u skualifikuar, ne kemi evidentuar 3 (tre) raste: rastin e {...}, rastin e {...} dhe rastin e {...}.

Në rastin e aplikantes Kamela Hoxha, rezulton që të jetë skualifikuar për shkak se eksperiencia në punë nuk përputhet me profilin përkatës për shkak të kandidimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit na rezulton që {...} është e punësuar si juriste pranë një personi fizik, konkretisht person fizik tregtar {...}, i cili është i regjistruar edhe në QKB, por për shkak edhe të emërimit që ka pasur “{...}”, ne kemi konkluduar tek fakti që eksperiencia e saj si juriste vërtetohet edhe në faktin e pagimit të sigurimeve shoqërore dhe për këtë arsye mendojmë që Shkolla e Magjistraturës të rishikojë edhe një herë qëndrimin e vet për këtë rast.

Rasti i dytë është rasti i {...} e cila për një periudhë kohe, sipas dokumentacionit të paraqitur, ka punuar administratore. Është qartësuar saktë tek relacioni. Të gjithë kemi edhe konceptin mbi rolin dhe figurën e administratorit dhe detyrat e tij funksionale dhe mendojmë që administratori (personi privat apo juridik) të trajtohet njësoj si drejtuesi i një institucioni publik dhe për këtë arsye mendojmë që kjo të konsiderohet si përvojë pune, e cila është e barasvlershme me përvojën që kërkohet për të kandiduar për profilin gjyqtar (që kërkohet nga ligji) dhe mendojmë që Shkolla e Magjistraturës ta rishikojë edhe një herë qëndrimin e vet, duke sugjeruar për të marrë në konsideratë, duke vlerësuar dokumentacionin dhe njëkohësisht edhe profilin apo llojin e punës së bërë të reflektuar në dokumentacionin përkatës.

Ndërsa në rastin e {...} gjykojmë që në dokumentacionin e dorëzuar, i cili u dorëzua edhe si ndihmëse nga ana e aplikantes përkatëse, rezultoi që në tërësinë e tyre, eksperiencia e saj e punës është një eksperiencë e barasvlershme me eksperiencën e duhur për të kandiduar për magistratë, profili gjyqtar, por ajo çfarë kjo kandidate nuk plotëson është kohëzgjatja e marrëdhënieve të saj të punës. Për këtë shkak, si referuam tek rasti i

ndihmësve, referuam që për përllogaritjen e kohëzgjatjes dhe për këtë sugjerimje edhe për Shkollën e Magjistraturës në tërësi, të marrë në konsideratë datën e fundit të aplikimeve, duke i bërë një trajtim të barabartë të gjithë kandidatëve.

Ndërsa për kandidatët e tjerë, të cilët janë të shumtë në numër nuk kemi qëndrime apo nuk kemi gjetje në raport me ato çfarë janë konstatuar nga Shkolla e Magjistraturës. Kështu që në mënyrë të përmbledhur e nderuar Kryetare, ky ishte relacioni edhe për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, duke u ndalur tek evidentimi i atyre rasteve të cilat neve mendojmë të bëjmë sugjerimet përkatëse drejt Shkollës së Magjistraturës.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Rusi!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim për sa u relatua.

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin dhe miratimin e komenteve dhe sugjerimeve mbi rezultatet e vlerësimit të bërë nga Shkolla e Magjistraturës, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Posaçëm.

Ilir Rusi: Pro propozimit.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro me rekomandimet.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2022-2023”, sipas tekstit bashkëlidhur (propozuar nga Komisioni përkatës).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.04.2022)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatorë znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Yllka Rupa*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ridvan Hado*, i cili në mbledhjen e datës 17 janar 2022 ka deklaruar papajtueshmërinë e tij për të marrë pjesë në çështjen në fjalë.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashtë.*
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatorë znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës për sot, që ka të bëjë me caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor dhe do të relatohet nga zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, përpara fillimit të relatimit, do të rikujtoja që zoti Hado nuk duhet të jetë pjesë e mbledhjes lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke qenë se në mbledhjen plenare të datës 17.01.2022 ai ka deklaruar papajtueshmërinë e tij për të marrë pjesë.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Po tërhiqem!

Naureda Llagami: Klodi të lutem mundëso shkëputjen e zotit Hado.

(Del nga platforma “online” zoti Hado.)

Marçela Shehu: Sikurse edhe ju e relatuat zonja Kryetare, Komisioni i Disiplinës ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim para mbledhjes plenare projektvendimin “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë”, duke u bazuar si më poshtë.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datë 22.04.2021, me nr. {...} prot., është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, me vendimin nr. 175, datë 26.04.2021, mbi bazën e shortit, Këshilli ka vendosur caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor z. {...}, në cilësinë e relatorit të çështjes.

Me vendimin Nr. 463, datë 11.10.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është disponuar dhënia, ndaj këtij subjekti e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” sipas përcaktimeve të nenit 58, pika 1 dhe nenit 61, të Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Me vendimin nr. 581, datë 13.12.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 5, datë 20.12.2018, “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, si dhe në vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve më datë 08.10.2021, ka vendosur deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...}.

Në vijim, Këshilli, me vendimin nr. 601, datë 23.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të tij “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, në mbështetje të nenit 62 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 13, datë 18.01.2019 të tij “Mbi ngritjen

dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”; vendimit nr. 5, datë 20.12.2018 të tij; vendimit nr. 581, datë 13.12.2021 të Këshillit, ka vendosur që përbërja e Komisioneve të Përhershme të jetë si vijon: “... Komisioni Disiplinor Anëtarë: Marçela Shehu, Ridvan Hado dhe {...}. Anëtarë zëvendësues Dritan Hallunaj dhe Alban Toro”.

Me Vendimin nr. 11, datë 17.01.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor, pas hedhjes së shortit, ka vendosur:

“Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. {...}, në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates, znj. {...}”.

Ndërkohë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 5, datë 20.12.2018, “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, si dhe në vendimin e nr. 22, datë 24.02.2022 të Kuvendit të Shqipërisë, me vendimin nr. 77, datë 02.03.2022 ka vendosur:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 62 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, vendimeve të tij nr. 13, datë 18.01.2019 “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar; nr. 5, datë 20.12.2018; nr. 77, datë 02.03.2022 dhe nr. 78, datë 02.03.2022, me vendimin nr. 79, datë 02.03.2022 ka vendosur:

“Vendimi nr. 13, datë 18.01.2019 i KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar, me vendimin nr. 601, datë 23.12.2021, ndryshon si më poshtë:

1.... Për Komisionin Disiplinor (KD)

Në vend të z. {...} zgjidhet z. Ilir Rusi....”

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, ka iniciuar një procedurë individuale administrative, e cila ka lidhje me statusin profesional të magjistrates në fjalë, në referim të nenit 63 të ligjit nr.

115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit të ri të çështjes. Relator për këtë çështje do të caktohet njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Lidhur me propozimin:

Nga sa u parashtrua, Komisioni Disiplinor, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në nenet 138 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në nenin 16 të Rregullores "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor", i propozon mbledhjes plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjistrates, znj. {...}.

Lidhur me procedurën e shortit, në kushtet kur, anëtari i Komisionit Disiplinor z. Ridvan Hado, ka deklaruar me shkresën nr. {...} prot., datë 17.01.2022 përpara mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, papajtueshmërinë për pjesëmarrje në procedimin disiplinor të magjistrates {...}, Komisioni Disiplinor propozon që në short të përfshihen dy anëtarët e përhershëm të tij znj. Shehu dhe z. Rusi, si dhe anëtari zëvendësues Dritan Hallunaj, në referim të nenit 16 pika 3 të Rregullores për Procedurat Disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor ku përcaktohet se: "Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit të çështjes, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë".

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. ____ (që do të përzgjidhet nga procedurat e shortit).

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates.

Në fund të projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi, konkretisht në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse edhe anëtarët e Këshillit do të jenë dakord, unë do të ftoja të vijojmë me procedurën e shortit lidhur me procedimin disiplinor ndaj magjistrates zonjës {...}, konkretisht për procedimin disiplinor nr. 1/2021, short i cili do duhet të hidhet midis tre anëtarëve: znj. Shehu, z. Rusi dhe z. Hallunaj.

Jemi gati për procedurën e shortit nëse nuk ka ndonjë koment apo kundërshtim nga anëtarët.

Atëherë, vijoje?

Procedura e shortit si vijon:

Futen me radhë tre shiritat e letrës me emrat e anëtarëve: z. Ilir Rusi, znj. Marçela Shehu dhe z. Dritan Hallunaj.

Pas përzgjedhjes, nga shorti rezulton i përzgjedhur relator z. Dritan Hallunaj.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Pro.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

(Rivoton zonja Luli, dakord.)

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Dritan Hallunaj në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Atëherë, me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor